



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
NJËSIA E PROKURIMIT

Kamëz, më \_\_. \_\_. 2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje uji të pijshëm për kopshte dhe çerdhe”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) 15981100-9

VLERA E FONDIT LIMIT: **5,666,666.67 (pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Bashkia Kamëz**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.*

*Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

*Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.*

*Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më

pak se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues në fushën objekt prokurimi, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë analizë bakteriorologjike e lëshuar nga ISHP si dhe të paraqesë raport analizash nga AKU për ujin e ofruar. Raporti i analizave duhet të jetë jo më shumë se 3 muaj para hapjes së procedurës së prokurimit.

**Argumentim:** Kërkesat e mësipërme janë bazuar në nenin 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Ky kriter vendoset me qëllim garantimin e sigurisë dhe cilësisë së ujit që do të furnizohet gjatë zbatimit të kontratës. Duke qenë se uji është produkt i konsumit të drejtpërdrejtë nga fëmijët, është e domosdoshme që operatori ekonomik të provojë përputhshmërinë e tij me standardet higjieno-sanitare dhe kërkesat ligjore në fuqi. Për këtë arsye kërkohet paraqitja e analizës bakteriorologjike të lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik, e cila vërteton se uji plotëson parametrat mikrobiologjikë dhe nuk paraqet rrezik për shëndetin e fëmijëve.
- Gjithashtu kërkohet raport analizash nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për ujin e ofruar, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e produktit me standardet e sigurisë ushqimore dhe kontrollit zyrtar. Kushti që raporti i analizave të jetë jo më i vjetër se 3 muaj nga data e hapjes së procedurës së prokurimit vendoset për të garantuar që analizat reflektojnë gjendjen aktuale të cilësisë së ujit dhe nuk bazohen në të dhëna të vjetruara.

**2.3.3** Operatori duhet të disponojë të paktën 1 (një) automjet për transportin e mallit, të cilin duhet t'a ketë në pronësi ose me qira.

*Për mjetin që është në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton leja e qarkullimit; çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm dhe taksa vjetore. Për mjetin që është me qira duhet të paraqitet kontrata e qirase.*

*Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën. Numri dhe lloji i mjetit janë vlerësuar të nevojshme, duke ju referuar natyrës dhe permasat e kontrates, vendi ku do të dorezohet malli, si dhe kohezgjatjes së furnizimit të tyre.

- Duke qenë se furnizimi duhet të kryhet në disa Kopshte dhe Çerdhe dhe në mënyrë të vazhdueshme, disponimi i të paktën një mjeti transporti nga operatori ekonomik është i nevojshëm për të siguruar kapacitetin logjistik të shpërndarjes.
- Kërkesa që mjeti të jetë në pronësi ose me qira synon të garantojë që operatori ekonomik ka në dispozicion mjetin e nevojshëm gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës dhe është në gjendje të përballojë në kohë kërkesat për furnizim, duke shmangur vonesat ose ndërprerjet në shërbim. Vendosja e këtij kriteri konsiderohet proporcionale dhe e arsyeshme, pasi lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës dhe me nevojën për të siguruar furnizim të rregullt me ujë për institucionet arsimore parashkollë, ku prioritet është garantimi i shërbimit në kohë dhe në kushte të përshtatshme transporti.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të deklarojë që në momentin e dorëzimit, malli të jetë sipas specifikimeve të kërkuara.

**Argumentim:** Në bazë të nenit 40, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi sipas standardeve.

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- EN ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- EN ISO 22000:2018 (Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është një standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka si qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikate lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Certifikata **EN ISO 9001:2015** lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë. Certifikata **EN ISO 14001:2015** për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik operon në përputhje me praktikën e mbrojtjes së mjedisit, duke minimizuar ndikimet negative që mund të vijnë nga aktiviteti i transportit dhe shpërndarjes së ujit. Certifikata **EN ISO 22000:2018** për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore kërkohet duke qenë se objekti i kontratës lidhet me furnizimin me ujë për konsum njerëzor. Ky standard garanton që operatori ekonomik zbaton kontrolle dhe procedura të përshtatshme për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me sigurinë ushqimore gjatë gjithë zinxhirit të furnizimit.

**2.3.6** Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar objektin e kësaj procedure prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar **1 shofer** dhe **2 punonjës të thjeshtë**, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e tyre për muajin e fundit.

Për punonjësin shofer të paraqitet leje drejtimi dhe kontratë pune, ndërsa për punonjësit e thjeshtë të paraqitet kontratë pune përkatëse;

**Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:**

Nr	Emër Mbiemër	Profesioni
----	--------------	------------

*Në rastin kur punonjësi Shofer është i kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

***Shënim:** Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Dokumentet e kërkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

***Argumentimi:** Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 pika 4 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 5 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesëmarrës. (Kërkesa për numrin minimal të punonjësve është përcaktuar duke patur parasysh sasinë e pajisjeve të nevojshme, afatin e përcaktuar për lëvrimin e kontratave).*

*Ky kriter vendoset për të garantuar që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm njerëzor për realizimin e kontratës në mënyrë të rregullt dhe pa ndërprerje. Furnizimi dhe shpërndarja e ujit në kopshtet dhe çerdhet kërkon angazhimin e personelit për proceset e ngarkim-shkarkimit, transportit dhe shpërndarjes së produktit. Përcaktimi i një numri minimal prej 1 shoferi dhe 2 punonjësish të thjeshtë, synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon staf të mjaftueshëm për të përballuar detyrimet kontraktuale dhe për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës.*

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mujor i punonjësve të siguruar të jetë jo më pak se 3 (tre) punonjës.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listëpagesat përkatëse për muajin e fundit.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara*

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

**Argumentim:** Kërkesat e mësipërme janë bazuar në nenin 40, pika 5 gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

- Ky kriter vendoset për të garantuar që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm njerëzor për realizimin e kontratës në mënyrë të rregullt dhe pa ndërprerje. Furnizimi dhe shpërndarja e ujit në kopshtet dhe çerdhet kërkon angazhimin e personelit për proceset e ngarkim-shkarkimit, transportit dhe shpërndarjes së produktit. Përcaktimi i një numri minimal prej 3 (tre) punonjësish të siguruar synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon staf të mjaftueshëm për të përballuar detyrimet kontraktuale dhe për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës.
- Kërkesa për paraqitjen e listëpagesave për muajin e fundit shërben për të vërtetuar ekzistencën reale të marrëdhënies së punës dhe numrin mesatar të punonjësve të deklaruar nga operatori ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore dhe marrëdhëniet e punës. Ky kriter konsiderohet i arsyeshëm dhe proporcional me natyrën dhe përmasat e kontratës, pasi lidhet drejtpërdrejt me garantimin e kapaciteteve organizative dhe njerëzore për realizimin e furnizimit në kohë dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet paraqesë çertifikatën e konformitetit të ambalazhit (bidona 19 litra) lëshuar nga prodhuesi dhe çertifikatën e konformitetit për aparatën (dispenser) lëshuar nga prodhuesi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë çertifikatën e konformitetit, që i shërbejnë objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

- Ky kriter vendoset për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve që do të përdoren për furnizimin me ujë në kopshtet dhe çerdhet. Duke qenë se uji do të shpërndahet në bidona 19 litra dhe do të konsumohet përmes aparateve (dispenser), është e domosdoshme që këto pajisje dhe ambalazhe të jenë në përputhje me standardet e sigurisë dhe të materialeve që janë në kontakt me ushqimin. Për këtë arsye kërkohet paraqitja e çertifikatës së konformitetit të ambalazhit (bidon 19 litra) të lëshuar nga prodhuesi, e cila vërteton se materiali i përdorur për prodhimin e bidonëve është i përshtatshëm për kontakt me produkte ushqimore dhe nuk ndikon në cilësinë apo sigurinë e ujit të pijshëm.
- Gjithashtu kërkohet çertifikata e konformitetit për aparatën (dispenser) e lëshuar nga prodhuesi, për të garantuar që pajisja plotëson standardet teknike dhe të sigurisë për përdorim në shpërndarjen e ujit për konsum njerëzor. Vendosja e këtij kriteri synon të sigurojë mbrojtjen

*e shëndetit të fëmijëve dhe të garantojë që produktet e përdorura gjatë zbatimit të kontratës janë në përputhje me standardet përkatëse të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.*

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryej shërbimin e transportit dhe dorëzimin e mallit objekt prokurimi pranë ambienteve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe të marrin përsiper shërbimin e transportit si dhe dorëzimin e mallit në godinat e kopshteve dhe çerdheve. Deklarata është dëshmi që vërteton marrjen e përgjegjesive nga operatorët ekonomike dhe krijon një besueshmeri dhe siguri për autoritetin, për furnizimin dhe transportimin e mallit pranë Autoritetit Kontraktor.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin **nr. 3060/1, datë 13.03.2026** të Titullari të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe referuar nevojave specifike të vetë AK për artikujt objekt prokurimi.

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit ka marrë parasysh çmimet e tregut, mbështetur në nenin 76 gërma ”b” e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: ... b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim...”.*

Hartimi i specifikimeve teknike per furnizimin me ujë te pijshëm bazohet në nevojën për të garantuar cilësi, siguri për shendetin e fëmijëve në kopshte dhe cerdhe. Specifikimet teknike, preventivi me zërat e mallrave janë pjesë e pandarë e DST.